



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E FINANCËS, BUXHETIT DHE MFK
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

RELACION

**PËR MIRATIMIN E KONTRIBUTIT FINANCIAR TË BASHKISË KORÇË PËR
FINANCIMIN E PROJEKTIT RIKONSTRUKSIONI SHKOLLËS 9-VJEÇARE
“SEVASTI QIRIAZI”, ME CIKËL FINANCIMI 2024-2025**

Në zbatim të urdhërit nr. 705 datë 29.12.2023 “Për shpalljen e thirrjes së parë për financimin e projekteve nga programet “Arsimi bazë”, “Arsimi i mesëm” dhe programi “Për sportin”, pjesë e programit për Infrastrukturën Shkollore e Sportive, për projektet me cikël financimi 2024-2025”, si dhe shkresës me nr. 1818/3 prot., datë 11.3.2024 “Njoftim për shpalljen fitues të projekteve të aplikuara pranë MAS, për objekte shkollore të arsimit parauniversitar dhe programit për sportin”, Bashkia Korçë është shpallur fitues për projektin “Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Sevasti Qiriazi”, Korçë.

Duke u bazuar si më sipër, financimi për këtë objekt nga ana e Bashkisë Korçë është 20% dhe financimi nga MAS është 80%.

Gjithashtu Bashkia Korçë do të planifikojë nga të ardhurat e saj, vlerën e mbikqyrjes dhe kolaudimit për këtë objekt. Duke u bazuar në ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr.97/2023 datë 07.12.2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, udhëzimin plotësues nr. 1 datë 24.1.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, VKB nr. 167 datë 29.12.2023 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2024 dhe PBA 2024-2026 të Bashkisë Korçë”, në urdhërin nr. 705 datë 29.12.2023 “Për shpalljen e thirrjes së parë për financimin e projekteve nga programet “Arsimi bazë”, “Arsimi i mesëm” dhe programi “Për sportin”, pjesë e programit për Infrastrukturën Shkollore e Sportive, për projektet me cikël financimi 2024-2025”, si dhe urdhrin nr. 22 datë 15.1.2024 “Për detajimin e shpenzimeve për investime për vitin 2024 të Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë” sipas programeve dhe projekteve”, kërkojmë nga Këshilli Bashkiak të miratojë kontributin financiar të Bashkisë për vitet 2024-2025 si më poshtë:

/lekë

| Nr. | Emërtimi i projekteve | Vlera e totale e projektit | Kontributi 20% Bashkia | Angazhimi 10% 2024 | Angazhimi 10% 2025 | Kontributi 80% MAS | Angazhimi 2024 | Angazhimi 2025 |
|-----|--|----------------------------|------------------------|--------------------|--------------------|--------------------|-------------------|-------------------|
| 1 | Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Sevasti Qiriazi", Korçë | 71,241,573 | 14,248,315 | 7,124,158 | 7,124,157 | 56,993,258 | 16,000,000 | 40,993,258 |
| 2 | Mbikqyrje e objektit "Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Sevasti Qiriazi", Korçë | | 654,788 | 654,788 | | | | |
| 3 | Kolaudimi i punimeve për objektin Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Sevasti Qiriazi", Korçë | | 78,574 | 78,574 | | | | |
| | Total | 71,241,573 | 14,981,677 | 7,857,520 | 7,124,157 | 56,993,258 | 16,000,000 | 40,993,258 |

-Angazhimin buxhetor i Bashkisë për vitin 2024 në vlerën prej 7,857,520 lekë do të përballohet nga fondi i planifikuar për objektin “Investime në shkollat e arsimit bazë parashkollor”, në programin arsimit bazë parashkollor AG122, me këtë strukturë buxhetore:

Programi AG122 Prod. P912AAA 00 09120 05 Art. 2310000 7,857,520 lekë

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E FINANCËS
BUXHETIT DHE MFK

Valbona Ziko

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE
KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Zhaneta Lubonja

DREJTORE E DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE TË BURIMEVE

NJERËZORE

Anxhela Qeramixhi (Dishnica)

KRYETARI I BASHKISË

SOTIRAQ FILO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK**

P/VENDIM

Nr. _____ Datë _____

**PËR MIRATIMIN E KONTRIBUTIT FINANCIAR TË BASHKISË KORÇË PËR
FINANCIMIN E PROJEKTIT RIKONSTRUKSIONI SHKOLLËS 9-VJEÇARE
“SEVASTI QIRIAZI”, ME CIKËL FINANCIMI 2024-2025**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në analizë materialin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe MFK, duke u bazuar në ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr.97/2023 datë 07.12.2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, udhëzimin plotësues nr. 1 datë 24.1.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, VKB nr. 167 datë 29.12.2023 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2024 dhe PBA 2024-2026 të Bashkisë Korçë”, në urdhërin nr. 705 datë 29.12.2023 “Për shpalljen e thirrjes së parë për financimin e projekteve nga programet “Arsimi bazë”, “Arsimi i mesëm” dhe programi “Për sportin”, pjesë e programit për Infrastrukturën Shkollore e Sportive, për projektet me cikël financimi 2024-2025”, si dhe urdhërin nr. 22 datë 15.1.2024 “Për detajimin e shpenzimeve për investime për vitin 2024 të Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë” sipas programeve dhe projekteve”, mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të këshilltarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë kontributin financiar të Bashkisë Korçë për financimin e projektit Rikonstruksioni shkollës 9-vjeçare “Sevasti Qiriazi”, me cikël financimi 2024-2025 sipas tabelës së mëposhtme:

/lekë

| Nr. | Emërtimi i projekteve | Vlera e totale e projektit | Kontributi 20% Bashkia | Angazhimi 10% 2024 | Angazhimi 10% 2025 | Kontributi 80% MAS | Angazhimi 2024 | Angazhimi 2025 |
|-----|--|----------------------------|------------------------|--------------------|--------------------|--------------------|-------------------|-------------------|
| 1 | Rikontrksion I shkollës 9-vjeçare "Sevasti Qiriazi", Korçë | 71,241,573 | 14,248,315 | 7,124,158 | 7,124,157 | 56,993,258 | 16,000,000 | 40,993,258 |
| 2 | Mbikqyrje e objektit "Rikontrksion I shkollës 9-vjeçare "Sevasti Qiriazi", Korçë | | 654,788 | 654,788 | | | | |
| 3 | Kolaudimi I punimeve për objektin Rikontrksion I shkollës 9-vjeçare "Sevasti Qiriazi", Korçë | | 78,574 | 78,574 | | | | |
| | Total | 71,241,573 | 14,981,677 | 7,857,520 | 7,124,157 | 56,993,258 | 16,000,000 | 40,993,258 |

2. Angazhimin buxhetor i Bashkisë për vitin 2024 në vlerën prej 7,857,520 lekë do të përballohet nga fondi i planifikuar për objektin “Investime në shkollat e arsimit bazë parashkollor”, në programin arsimit bazë parashkollor AG122, me këtë strukturë buxhetore:

Programi AG122 Prod. P912AAA 00 09120 05 Art. 2310000 7,857,520 lekë

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe MFK si dhe Drejtoria e Prokurimeve.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miraturar me _____vota

Vota Pro _____

Vota Kundër _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur më datë _____

K R Y E T A R

Ana Verushi